


demost<sup>ti</sup>

Nr 113; 15.03.2017

NE MBAJME



ÇELËSIN  
E SË ARDHMES

## BOTA E DEMOKRACISË

DRILON (14), YLLKA (14), ARTURI (14), BLEONA (15), DRILONA (14), BLINERA (15)



**A keni menduar se çka është demokracia dhe se si është të jetosh në një shtet demokratik? Nëse po dhe doni të dini më shumë, lexojeni artikullin**

**A thua si do të paramendohej jeta pa demokraci?**

Jeta pa demokraci, do të ishte një jetë ku nuk do të ndiheshim të lirë e të barabartë me të gjithë njerëzit e tjerë. Kurse, ne e kemi fatin që të jetojmë në një botë ku ka demokraci.

Demokracia është sistem ku si parim themelor e ka: lirinë e njeriut. Këtu përfshihen: e drejta e fjalës, e drejta e votës si dhe barazia e njerëzve në botë, p.sh. barazia gjinore, ku gratë dhe burrat i kanë të gjitha të drejtat e barabarta.

Fjala demokraci rrjedh nga greqishtja e vjetër, ku „demo“ do të thotë popull dhe „kratia“ do të thotë udhëheqje. Në njëfarë mënyre, në shikim të parë e kuptojmë se kemi të bëjmë me udhëheqjen ku ndikimin kryesor e ka populli.

Fjala „udhëheqje“ ka shumë kuptime si: ai që mban rend, ai që përfaqëson, etj. Kemi dy forma të demokracisë, e që janë: forma e drejtpërdrejtë, ku populli merr vendime të ndryshme aty për aty dhe forma përfaqësuese, ku i mundësohet popullit të marr vendime të ndryshme me të drejtën e votës. Demokracia përfaqësuese ndahet në dy sisteme: sistemin parlamentar dhe sistemin presidencial. Në demokracinë përfaqësuese me sistem parlamentar populli zgjedh Parlamentin e pastaj Parlamenti zgjedh Presidentin.

Shumë kohë më parë në shekullin e IV-V, para erës sonë, demokracia ishte e zhvilluar vetëm në Athinë, mirëpo ajo tash është e pranishme pothuajse në të gjitha vendet e botës.

Shpresojmë që në të ardhmen e afërt e gjithë bota të jetë demokratike.



Kuptimi i fjalës demokraci




Përfaqësuesit e grupit

# JA SE SI NDAHET PUSHTETI NË KOSOVË

LEOTRIM (15), ERBLIN (14), ALBIN (15), ARDIT (15), BLERONA (14), DIELLZA (15)

## Ndarja e pushtetit



### Ne jemi nxënës nga shkolla „Gj.K. Skënderbeu“ dhe në Punëtorinë e Demokracisë „Demos-ti“ kemi diskutuar për ndarjen e pushtetit. Informatat që kemi mësuar mund t'i lexoni më poshtë

Pasi që ne jemi shtet demokratik ku respektohen parimet e demokracisë, pushteti në Kosovë ndahet në tri pjesë. Këto pushtete janë: Pushteti Legjislativ, Ekzekutiv dhe ai Gjyqësor. Pushteti Legjislativ është i Kuvendit të Kosovës, i cili i aprovon apo miraton ligjet me të cilat funksionon i gjithë shteti. Pushteti Ekzekutiv përbëhet nga Qeveria, Presidenti, Policia e Kosovës dhe Forcat e Sigurisë së Kosovës. Detyra e këtyre institucioneve është që t'i zbatojnë dhe praktikojnë ligjet. Pushteti Gjyqësor, i cili përbëhet nga gjykatat ka për detyrë t'i gjykojë qytetarët, të cilët dyshohet se e kanë thyer ligjin. Gjykatat në Kosovë ndahen në disa lloje, ato janë: Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme. Në çdo komunë të Kosovës kemi Gjykatë Themelore, e cila gjykon të gjitha rastet. Ndërsa, nëse personi i akuzuar nuk është i kënaqur me vendimin e Gjykatës Themelore, ka të drejtë të bëjë apel tek Gjykata e Apelit, e deri te Gjykata Supreme. Në gjykatë janë të pranishëm: gjykatësit, prokurorët, avokatët, i pandehuri, dëshmitarët etj. Pushteti Ekzekutiv përfshinë disa institucione, por më i rëndësishmi ndër to është institucioni i Qeverisë, i cili i zbaton ligjet. Në Qeveri punojnë: Kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat e ministrive të ndryshme. Qeveria zgjed-

het nga deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe ka mandat 4 vjeçar. Edhe Presidenti zgjedhet nga deputetët e Kuvendit, por ka mandat 5 vjeçar. Presidenti ka rol të rëndësishëm në përfaqësimin e vendit tonë edhe në vendet e huaja. Kurse, Policia e Kosovës është e pavarur nga institucionet e tjera të vendit dhe për detyrë ka mbrojtjen e qytetarëve të Kosovës.

Ne mendojmë se nëse ndahet pushteti, atëherë institucionet e pushtetit do të ishin kuptuar shumë më lehtë dhe nuk do ta keqpërdornin rolin e tyre, të cilin e kanë marrë me votat e qytetarëve. Nëse ne dëshirojmë të ndërtojmë një shkollë të re ne do t'i ndanim punët në mes vete. Njëri nga ne do ta bënte planin e shkollës, tjetri do ta bënte dizajnin e shkollës, dikush do të ndërtonte muret, e dikush dyert. Mirëpo të gjithë do të punonim së bashku në mënyrë që shkolla jonë e re të duket më e bukur dhe më e fortë.



Gazetarët më të rinjë të Kuvendit të Kosovës




## Në këtë pjesë të artikullit do të mund të lexoni nga ne disa fakte për Kuvendin e Kosovës, të cilat ne i kemi mësuar gjatë ditës së sotme


Kuvendi i Kosovës është institucioni më demokratik i Kosovës. Kuvendi i Kosovës i përket degës së Pushitetit Legjislativ. Kjo do të thotë se Kuvendi, i shkruan dhe i miraton ligjet e reja të Kosovës. Propozimin e ligjeve kanë të drejtë ta bëjnë shumë institucione duke filluar nga Qeveria, Presidenti e deri tek deputetët e Kuvendit dhe rreth 10.000 qytetarë të Kosovës. Ne kemi mësuar se në Kuvend punojnë 120 deputetë. Ata ndahen në pozitë dhe opozitë. Pozita është partia e cila ka fituar më së shumti vota në zgjedhje, ndërsa opozita përbëhet nga partitë që kanë fituar më pak vota. Nga 120 deputetë, 100 prej tyre i përkasin kombit shqiptar ndërsa 20 të tjerë i përkasin komuniteteve jo shumicë si: egjiptian, ashkali, romë, boshnjak, serbë etj. Ligjet që nxjerren nga Kuvendi i Kosovës duhet të përshtaten me Kushtetutën e Kosovës. Prandaj, edhe ky institucion është kaq i rëndësishëm për ne.




Kushtetuta jonë



Ja se si duket salla e Kuvendit tonë



Simboli i Gjykatës




Barazia mes racave, shumë e rëndësishme për ne



Albini duke vizatuar sallën e Kuvendit të Kosovës

## TI VLEN

ALBAN (15), ARDI (14), ALTIN (15), DONJETA (15), FIONA (14), SAMIRJA (15)

 Voto edhe ti



Të gjithë kemi drejtë të votojmë

### A e dini se zgjedhjet janë...

Zgjedhjet janë elementi që çdo qytetari ia lehtësojnë jetën. A thua pse vallë themi kështu? Zgjedhjet jo vetëm që përmirësojnë jetën tonë por po ashtu na mundësojnë neve, si qytetarë që ta jetësojmë një të drejtë tonën. Ajo është e drejta e votës. Zgjedhjet luajnë rol të rëndësishëm në çdo hap të jetës sonë dhe nuk janë të rëndësishme vetëm për qytetarë të caktuar, por po ashtu janë shumë të rëndësishme edhe për zhvillimin e një shteti. Vota e një qytetari luan një rol të rëndësishëm, p.sh. një zgjedhje të zakonshme që ne e bëjmë është zgjedhja e kryesisë së klasës. Zgjedhja apo mos zgjedhja e kryetarit të klasës mund të varet vetëm nga një nxënës i klasës, d.m.th. vota e çdo njërit nga ne është shumë e rëndësishme.

Në Kosovë zhvillohen dy lloje të zgjedhjeve: zgjedhjet lokale (komunale) dhe ato qendrore. Tek zgjedhjet

lokale qytetarët votojnë për kryetarin e komunës dhe ansambleistët, kurse në zgjedhjet qendrore qytetarët i votojnë partitë politike në kuadër të së cilave janë edhe kandidatët për deputetë.

Deputetët e zgjedhur mund të jenë edhe deputetë të pavarur. Për të marrë pjesë në procesin zgjedhor ka të drejtë çdo qytetar i Republikës së Kosovës i cili është mbi moshën 18 vjeçare.

Çdo qytetar ka përgjegjësi për të votuar atë që e dëshiron dhe që mendon që ai person do t'i sigurojë një të ardhme më të mirë. Nga kjo kuptojmë se zgjedhjet përveç që janë të lira, po ashtu janë të drejtpërdrejta, të fshehta por mbi të gjitha janë demokratike. Janë demokratike, sepse çdo qytetar ka të drejtë të votoj, por po ashtu ka të drejtë të vendos vet për të ardhmen e tij/saj, si dhe për të ardhmen e vendit të vet. Vota jote vlen, andaj voto edhe ti!



Të drejtën për të votuar e arrijmë kur të mbushim 18 vjeç



Grupi i zgjedhjeve





## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:  
Tel: +381 38 704 560  
E-mail: [info@demos-ti.org](mailto:info@demos-ti.org)  
Website: [www.demos-ti.org](http://www.demos-ti.org)

Pjesëmarrësit:  
SHFMU „Skënderbeu“  
Klasa: IX-1  
Vendi: Pantinë, Vushtrri